

Nh: 2800 prot

dt: 21.09.2021



kyesë me vete

Z. Rektore

A. Kucukelaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4895 Prot.

Tiranë, më 17.09.2021

**URDHËR**

Nr. 334, Datë 17.09.2021

**PËR**

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER  
PROFESIONAL NË "SHËRBIMET SOCIALE", NË UNIVERSITETIN "LUIGJ  
GURAKUQI", SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master profesional në "Shërbimet sociale", në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, me 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit akademik (2 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e ciklit të dytë Master profesional në "Shërbimet sociale", në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional në "Shërbimet sociale", në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Evis KUSHI**

